



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**Anr. 01/2023**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi kryesues, Franciska Zhitija - Ymeri, dhe Arsim Hamzaj, anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, paraqitur kundër vendimit me numër 01/592-2023 i datës 04.05.2023, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me Certifikimin e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhje të Parakohshme për Kuvendin Komunal në Leposaviq, të mbajtura më 23.04.2023, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.05.2023, mori këtë:

### **V E N D I M**

**REFUZOHET** i pabazuar apeli Anr.01/2023 i datës 04.05.2023, i paraqitur nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, më të cilin ka kërkuar që të anulohet vendimi me numër 01/592-2023 i datës 04.05.2023, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), dhe të detyrohet KQZ-ja, që të bëjë certifikimin e 15 kandidatëve për kuvend komunal nga lista e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, në Zgjedhjet e Parakohshme në Komunën e Leposaviqit, të mbajtura me 23 Prill 2023.

### **A r s y e t i m**

Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje me datën 04.05.2023 ka paraqitur apel në PZAP-i me seli në Prishtinë, duke kontestuar vendimin me nr.01/592-2023 të datës 04.05.2023, të lëshuar nga KQZ-ja, lidhur me certifikimin e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin Komunal të Komunës së Leposaviqit, të mbajtura më 23 prill 2023. Ku me këtë vendim KQZ-ja ka bërë certifikimin e vetëm 12 kandidatëve të Subjektit Politik LVV, e jo të 15 kandidatëve të cilët janë certifikuar për zgjedhjet e 23 prillit 2023.

Me këtë vendim KQZ-ja ka bërë certifikimin e vetëm 12 kandidatëve të Subjektit Politik LVV, e jo të 15 kandidatëve të cilët janë certifikuar për zgjedhjet e 23 prillit 2023.

Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje në apelin e tij ka theksuar se vendimi me nr.01/592-2023, të datës 04.05.2023, e lëshuar nga KQZ-ja, është i gabuar dhe i kundërligjshëm në lidhje me çështjen e certifikimit të mandateve të fituara dhe kandidatëve të subjekteve politike, siç thuhet në vendim se KQZ-ja, nuk mund të certifikoj kandidatët që nuk kanë marrë asnjë votë, pra kanë fituar zero vota, me propozim për PZAP-in, dhe ka propozuar që apeli të aprovohet dhe të anulohet vendimi i KQZ-së, si dhe të urdhëroj KQZ-ën për certifikimin e 15 kandidateve nga lista e subjektit politik LVV.

KQZ-ja, ka paraqit përgjigje në apel me datën 05.05.2023 me të cilën ka theksuar se në mbledhjen Nr. 15/2023, të datës 28.04.2023, ka bërë certifikimin rezultatit të zgjedhjeve për

zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin Komunal në Zveçan, me përjashtim të rezultatit të zgjedhjeve për Kuvendin Komunal në Leposaviq, i cili nuk arriti të votohet me 2/3, për arsye të tre (3) kandidatëve që nuk kanë arritur të fitojnë vota, pra kanë pasur zero vota. Ndër të tjera ka theksuar, se shumica e anëtarëve të KQZ-së nuk u pajtuan që të marrin mandate kandidatët që kanë pasur zero vota, prandaj, nuk u çertifikua rezultati i zgjedhjeve për Kuvendin Komunal në Leposaviq edhe përkundër mos çertifikimit të këtij rezultati KQZ, nuk është njoftuar se ka pasur ndonjë ankesë në PZAP. Poashtu ka cek se Sekretariati i KQZ-së, në mbledhjen e KQZ-së Nr.16/2023, të datë 04.05.2023, i ka rekomanduar KQZ-së, çertifikimin e rezultateve zgjedhore për Kuvendin Komunal në Leposaviq, duke mos i përfshirë në listë tre (3) kandidatë që kanë pasur zero vota, pra kandidatët që nuk kanë arritur të fitojnë asnjë votë.

Paneli pas vlerësimit të shkresave të lëndës, fillimisht vërejti se nuk ka dispozitë ligjore në kuadër të Ligjit Për Zgjedhjet Lokale, dhe as për Zgjedhjet e Përgjithshme që parasheh apelimin ndaj vendimit për çertifikimin e rezultateve, megjithatë duke qenë se KQZ-ja, me vendimin që ka certifikuar rezultatet nr. 01/592-2023 të datës 04.05.2023, ku në pikën II të vendimit konstaton se Rekomandimi për çertifikimin e rezultateve zgjedhore për Kuvendin Komunal në Leposaviq si në pikën 1, janë të bashkangjitura këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse, ndërsa në tabelën për subjektet politike ku përcaktohet shpërndarja e përqindjes së votave për subjektet politike, konstatohet se Lëvizja vetëvendosje ka numër të ulëseve të fituara 15, mirëpo kur bëhet shpërndarja e votave të subjektit politik rezulton se çertifikohen vetëm 12 kandidat. Në situatën konkrete Paneli ka vlerësuar se duke qenë se KQZ-ja ka certifikuar numër prej 15 vendeve për subjektin politik ndërsa ka certifikuar vetëm 12 kandidat nga ky subjekt politik, në situatën e tillë është vlerësuar se duhet shqyrtohet në merita pretendimi ankimorë, rrjedhimisht për këto arsye nuk është hedhur si i palejuar apeli i parashtruar, përderisa nuk ka dispozitë specifike që rregullon se kundër vendimit për çertifikimin e rezultateve zgjedhore lejohet ankesa.

Paneli i vlerësoj pretendimet ankuesit, dhe përgjigjen në apel, si dhe duke i vlerësuar secilën provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, duke u mbështetur edhe në dispozitat e nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se apeli i ankuesit **është i pa bazuar** për këto arsye:

Paneli vlerësoi se KQZ-ja, në mbledhjen e datës 04.05.2023, pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotime, në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve, si dhe nga konfirmimet e marra nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës dhe Gjykata Supreme e Kosovës, ka bërë çertifikimin e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin Komunal në Leposaviq, ashtu siç që parashihen edhe me nenin 106 pika 1 i LZP-ës.

Në këtë rast nuk është kontestuese se numri i ulëseve të fituara për Kuvendin Komunal në Leposaviq, nga radhët e subjektit politik LVV, në Zgjedhjet e Parakohshme, të mbajtura më 23 Prill 2023, dhe nuk është kontestuese numri i votave të fituara nga Subjekti politik LVV, por kontestuese në këtë rast mbetet ndarja e ulëseve për kandidatët të cilët në rezultatet përfundimtare i figurojnë 0 vota.

Paneli vlerëson se pretendimet e parashtruesit të apelit për mos çertifikimin e 3 kandidatëve nga lista e kandidatëve për anetarë të Kuvendit Komunal në Leposaviq, janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara, sepse sipas nenit 8 pika 2 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, parasheh se *“Të gjitha votat e fituar nga kandidatët që janë në listën e kandidatëve të çdo subjekti politik, numërohen ndaras. Listat me kandidatë rirenditen sipas mënyrës zbritëse në bazë të numrit të votave të fituara për secilin kandidat”*.

Mbi këtë bazë, Paneli konstaton se KQZ-ja, me rastin e marrjes së vendimit (KQZ), 01/592-2023, të datës 04.05.2023, lidhur me çertifikimin e kandidatëve nga lista e kandidatëve nga radhët e Subjektit Politik LVV, me të drejt ka zbatuar dispozitën ligjore të nenit 8.2 Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, ngase neni 8 paragraf 2 i LZL-e i referohet votave të fituara nga kandidatët që janë në listën e kandidatëve të çdo subjekti politik, dhe për tu numëruar ndaras për secilin kandidat, duke nënkuptuar se nuk mund të çertifikohen kandidatët tjerë, në këtë rast 3 kandidatët që nuk kanë fituar asnjë votë.

Po ashtu Paneli vlerësoi pretendimet ankimore të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, se duke qenë përqindja e tërësishme e votave për Kuvendin Komunal në Leposaviq, kanë rezultuar që si subjekt kanë përfituar 15 ulëse nga totali i numrit të ulëseve për këtë kuvend komunal që janë 19 ulëse. Mirëpo nga kandidatët e këtij subjekti politik kanë arritur që të marrin vota vetëm 12 nga këta kandidatë, ndërsa kandidatë e tjerë në listë nuk rezultojnë se kanë marr ndonjë votë.

Duke qenë se çertifikimi i cilitdo kandidat në kuadër të listës së Subjektit Politik vetëm duke e marrë për bazë numrin e ulëseve të fituara nga Subjekti Politik, e në mungesë të votave për kandidatët në atë listë kjo do të konsistonte në shkelje të nenit 8 paragrafi 2 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale.

Paneli po ashtu ka parasysh faktin se, pretendimi i parashtruesit të ankesës lidhur me faktin se neni 8 i Ligjit për Zgjedhjet Lokale ka synim certifikimin e kandidatëve duke shkuar në zbritjen e numrit të marrjes së votave në përpjesëtim me numrin e ulëseve që ka marr subjekti politik, një pretendim i tillë për panelin është i pabazuar, nga se listat zgjedhore janë të hapura dhe shprehet vota për subjektin politik dhe për kandidatin, mirëpo fakti i marrjes së numrit të ulëseve nga ana e subjektit politik referohet mbi bazën e përqindjes së tërësishme të votave që ndahet sipas formulës që e bënë KQZ-ja, ndërsa kandidati duhet të fitoj vota për t’iu njohur rezultati i tillë se është fitues në kuadër të numrit të tillë të ulëseve që kanë rezultuar për subjektin politik që ka fituar.

Në rrethana të rastit konkret meqenëse për tre kandidatet në listë rezultojnë se asnjëri nga ta nuk ka marrë asnjë votë në zgjedhjet për kuvendin komunal në Leposaviq, kjo shpërfaq mungesë të rezultatit për kandidat andaj edhe nuk mund të çertifikohen si kandidat fitues në mungesë të votave.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më larte nuk mund te bëhet certifikimi i 15 kandidatëve për kuvend komunal nga lista e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, në Zgjedhjet e Parakohshme në Komunën e Leposaviqit, të mbajtura me 23. Prill 2023, si dhe në pajtim me nenin 115.1, nenin 117.3 e lidhur më nenin 118.1, të LZP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.01/2023 më datën 05.05.2023

**Kryesuesi i Panelit**

Burim Ademi

***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.